



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 135

Tiranë – E martë, 20 qershor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit të Republikës nr. 10407, datë 9.6.2017	Për lejmimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 6813
Dekret i Presidentit të Republikës nr. 10411, datë 12.6.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6813
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ankimet nr. 16191/13	Ana Veizi dhe të tjerët kundër Shqipërisë..... 6813
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 29, datë 7.6.2017	Për disa ndryshime në rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”..... 6815
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 30, datë 7.6.2017	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Veneto Banka sh.a..... 6821

**DEKRET**

Nr. 10407, datë 9.6.2017

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Juliana Soni Sadedini
2. Aferdita Nazif Shabani
3. Anxhela Sotiraq Kristo
4. Juljana Saba Hoxha
5. Taulant Enver Shehu
6. Servete Avdi Kartoçi
7. Bekim Ilir Latifi
8. Katharina Ilia Koja
9. Ylli Kol Mustafa
10. Henri Shpëtim Kamberi
11. Ivi Ardian Hysaj
12. Roland Sabri Dedej
13. Harilla Jani Steri
14. Edith Ismet Bushati
15. Ilva Thoma Herde (Ndoni)
16. Artan Qamil Danga
17. Majlinda Ndue Sommer (Caka)
18. Alketa Zenel Sulejmani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET

Nr. 10411, datë 12.6.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, nenit 14 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998,

“Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Artijan Martin Qollaku
2. Denis Fidelino Halo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

**GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I PARË**

VENDIM

**ANKIMET NR. 16191/13
ANA VEIZI DHE TË TJERËT KUNDËR
SHQIPËRISË**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i parë), e mbledhur më 28 mars 2017, si një Komitet i përbërë nga:

Aleš Pejchal, President

Ledi Bianku,

Jovan Ilievski, gjykatës,

dhe Renata Degener, zëvendëssekretare e Seksionit;

duke pasur parasysh ankimin e mësipërm, paraqitur më 5 dhjetor 2012;

duke pasur parasysh deklaratën e dorëzuar nga Qeveria, e paditur më 23 dhjetor 2016, sipas së cilës i kërkon Gjykatës të nxjerrë ankimin nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e ankuesit ndaj asaj deklarate;

pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë vijon:

FAKTET DHE PROCEDURA

Një listë me ankuesit paraqitet në shtojcë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentja e saj, znj. A. Hicka, e Zyrës së Avokatit të Shtetit.

Ankimi ka të bëjë me mungesën e pretenduar për një hetim efikas mbi vdekjen e anëtarëve të



familjes së ankuesve gjatë një proteste, e cila u zhvillua më 21 janar 2011. Ankuesit u shprehën se sipas nenit 2 dhe 13 të Konventës, atyre iu ishte mohuar e drejta për të marrë informacion në dosjen e hetimit. Në vijim, ata u ankuan edhe sipas nenit 6 të Konventës për një shkelje të së drejtës së tyre për të hyrë në gjykatë duke iu referuar refuzimit të Gjykatës së Rrethit, Tiranë, për të shqyrtuar padinë e tyre civile për dëmet, padi e cila ishte paraqitur gjatë procedimeve kryesore penale kundër të bashkakuzuarve, për shkak se ata nuk kishin paguar tarifatat gjyqësore të plota.

Ankimi iu komunikua Qeverisë.

Pas negociatave fillestare të pasuksesshme për një zgjidhje miqësore, me anë të letrës së datës 23 dhjetor 2016, Qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bënte një deklaratë për zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga ankimi. Në vijim, Qeveria i kërkoi Gjykatës ta nxirrte ankimin nga lista e çështjeve, në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Deklarata e datës 23 dhjetor 2016 ka përmbajtjen e mëposhtme:

“Qeveria shpreh keqardhjen për vdekjen e babait dhe vëllezërve të ankuesve në protestën e 21 janarit të vitit 2011. Palët pranojnë se kompensimi, duke përfshirë dëmet monetare dhe jomonetare në lidhje me këtë vdekje, do të adresohet nga gjykatat vendëse.

Në vijim, Qeveria pranon se hetimi i zhvilluar mbi rrethanat e vdekjes së vëllezërve të ankuesve nuk ishte në përputhje me nenet 2,13 dhe 6 të Konventës, dhe se këto çështje nuk janë adresuar në procedimet penale vendëse të përmendura më sipër.

Gjithashtu, Qeveria ndërmerr të rihapë procedimet penale vendëse në këtë çështje për të përfshirë të afërmit e viktimës në këto procedime.

Qeveria është e përgatitur të paguajë kompensim të drejtë për:

Ana Veizi, EUR 39,000 (tridhjetë e nëntë mijë euro)

Klajdi Veizi, EUR 39,000 (tridhjetë e nëntë mijë euro)

Zabit Deda, EUR 15,600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro)

Çaush Veizi, EUR 15,600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro).

Me qëllimin për një zgjidhje miqësore të çështjes së përmendur më sipër, e cila është pezull në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, dhe çdo pretendim tjetër në lidhje me këtë ngjarje, për të mbuluar çdo dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet plus, çdo taksë e cila mund t’iu tarifohet ankuesve.

Këto shuma do të kthehen në vlerën monetare vendëse në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të paguhen brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata për ta përjashtuar ankesën nga lista e çështjeve. Nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër, deri në kompensimin e plotë, interesi i thjeshtë do të paguhet mbi shumën e mësipërme, në një normë të barabartë me normën e huas marginale të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus pikë tre për qind.

Kjo deklaratë pa paragjykim është në të drejtën e ankuesve për t’u rikonsideruar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, sipas rregullave të saj, në rast se Qeveria nuk përmbush detyrimet e ndërmarra në këtë deklaratë”.

Në po të njëjtën ditë, Qeveria dorëzoi edhe një deklaratë tjetër të firmosur në mënyrë të rregullt nga përfaqësuesi i palëve, më 13 dhjetor 2016, në të cilën përsëriteshin të njëjtat kushte me ato të shprehura nga Qeveria në deklaratën e saj të njëanshme. Përfaqësuesit e ankuesve deklaruan si më poshtë vijon:

“Unë, D. Matlija, vërej se Qeveria e Shqipërisë është e përgatitur të pranojë deklaratën e mëposhtme (...)

Pasi jam konsultuar me ankuesit, unë ju informoj se ata e pranojnë propozimin dhe heqin dorë nga çdo kërkesë tjetër në lidhje me faktet që ngritën këtë ankim. Ata deklarojnë se kjo përbën një zgjidhje përfundimtare të çështjes”.

Më 13 janar 2017, Regjistri i Gjykatës mori një letër nga ankuesit, në të cilën informohej Gjykata se ata kishin rënë dakord me kushtet e deklaratës së Qeverisë.

LIGJI

Gjykata konstaton se pas dakordësisë së shprehur nga ankuesit në lidhje me kushtet e deklaratës së bërë nga Qeveria, çështja duhet trajtuar si një zgjidhje miqësore midis palëve.



Për këtë arsye, ajo njih zëdhjen miqësore midis palëve. Ajo gëzohet që zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut sipas përcaktimit në Konventë dhe në Protokollin e saj, dhe nuk gjen asnjë arsye për të vazhduar shqyrtimin e çështjes.

Në këtë pikëpamje është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë ankesën nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 20 prill 2017.

Renata Degener

Aleš Rejchal

Zëvendësregjistruese

President

SHTOJCË

1. Ana VEIZI, lindur më 10/12/1999, është shtetase shqiptare, e lindur në vitin 1999, banuese në Fier dhe e përfaqësuar nga D. Matlija.

2. Zabit DEDA, lindur më 01/05/1970, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1970, banues në Tiranë dhe përfaqësuar nga D. Matlija.

3. Caush VEIZI, lindur më 03/07/1972, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1972, banues në Gjirokastër dhe përfaqësuar nga D. Matlija.

4. Klajdi VEIZI, lindur më 01/10/1996, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1996, banues në Fier dhe përfaqësuar nga D. Matlija.

VENDIM

Nr. 29, datë 7.6.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VENDIMARRJES NË MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe paragrafit të fundit të pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 89, pika 9 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 109, pika 15 të ligjit nr. 52/2016 “Për shoqëritë e

kursim-kreditit dhe unionet e tyre” të kreut II, i pjesës së dytë të Kodit të Procedurave Administrative, miratuar me ligjin nr. 44/2015, me propozim të Guvernatorit dhe Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 2 shtohet shkronja “e”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 109, pika 15 e ligjit nr. 52/2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”.

b) Pas nenit 3 shtohet neni 3/1, “Kompetencat vendimmarrëse për SHKK-të dhe unionet e tyre”, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Në përjashtim nga dispozitat e parashikuara në kreun II të kësaj rregulloreje, përcaktimi i organeve dhe njësisve organizative, të cilat nxjerrin akte administrative individuale për SHKK-të dhe unionet e tyre buron nga neni 109, pika 15 e ligjit nr. 52/2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”.

c) Shtojcat bashkëlidhur rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.05.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ndryshohen sipas shtojcave nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 10 korrik 2017.

KRYETARI
Gent Sejko



SHTOJCA NR. 1
KOMPETENCA VENDIMMARRËSE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS PËR MBIKËQYRJEN E
VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

NR.	KOMPETENCA VENDIMMARRËSE	Referenca ligjore dhe rregullative
1	Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimit të kërkesës për licencimin e bankave ose degëve të bankave të huaja, si dhe/ose vendosja e kushteve shtesë.	Neni 19, pika 1 dhe pika 5 e ligjit “Për bankat”
2	Vendimi për dhënien ose refuzimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe/ose financiare bankës apo degës së bankës së huaj.	Neni 20 i ligjit “Për bankat”
3	Vendimi për zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së miratimit paraprak gjatë procesit të licencimit të bankës ose degës së bankës së huaj.	Neni 20, pika 6 e ligjit “Për bankat”
4	Vendimi për revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe/ose financiare të bankës ose degës së bankës së huaj.	Neni 28 dhe neni 74, pika 2, shkronja “d” të ligjit “Për bankat”
5	Vendimi për shfuqizimin e miratimit paraprak gjatë procesit të licencimit të bankës ose degës së bankës së huaj mbi mosplotësimin e kushteve për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë brenda afatit 12-mujor.	Neni 20, pika 6 e ligjit “Për bankat”
6	Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimit të kërkesës për kryerjen e veprimtarive shtesë për bankat ose degët e bankave të huaja.	Neni 23, pika 3 dhe pika 4, neni 24, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 2, shkronja “a” të ligjit “Për bankat” Neni 194, pika 4, neni 204, pika 5 e ligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, neni 18, pika 8 e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja”
7	Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës së bankës për riorganizimin e saj nëpërmjet bashkimit ose ndarjes, ose çdo forme tjetër të ngjashme.	Neni 24, pika 1, shkronja “k” e ligjit “Për bankat”; neni 24, pika 4 e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja”
8	Vendimi për bllokimin e aktiveve të degës së bankës së huaj, përcaktuar në pikën 7 të nenit 59 të ligjit “Për bankat”.	Neni 108, pika 2 e ligjit “Për bankat”
9	Vendimi për shpërndarjen e kapitalit të bankës.	Neni 24, pika 1, shkronja “i” e ligjit “Për bankat”
10	Vendimi për vendosjen e bankës në likuidim të detyruar. Vendimi për emërimin e likuidatorit.	Neni 74, pika 2, shkronja “dh”, neni 105, pika 1, shkronja “c”, neni 108, pika 1, neni 109, pika 1 dhe pika 2 dhe neni 111 të ligjit “Për bankat”
11	Vendimi për zëvendësimin e likuidatorit të bankës gjatë procesit të likuidimit të detyruar.	Neni 113, pika 2 e ligjit “Për bankat”
12	Vendimi për miratimin e raportit të likuidatorit mbi përfundimin e shpërndarjes së të gjitha aktiveve të bankës apo degës së bankës së huaj.	Neni 122, pika 2 e ligjit “Për bankat”
13	Vendimi për miratimin e dokumenteve “Misioni i Mbikëqyrjes Bankare”, “Politika e Mbikëqyrjes” dhe “Politika e Licencimit të subjekteve bankare”.	
14	Vendimi për përjashtimin e subjekteve financiare jo banka nga zbatimi i dispozitave të ligjit për bankat.	Neni 2, pika 3 e ligjit “Për bankat”
15	Vendimi për miratimin ose refuzimin e kushteve të propozuara nga likuidatori për shitjen e bankës.	Neni 119, pika 1, shkronja “b” e ligjit “Për bankat”
16	Vendimi për miratimin e Raportit vjetor të Mbikëqyrjes.	Neni 8 i ligjit “Për bankat”
17	Vendimi për miratimin e akteve nënligjore (rregulloreve, udhëzimeve dhe vendimeve me zbatim të përgjithshëm) për ushtrimin dhe realizimin e funksionit licencues dhe/ose mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.	Neni 12, shkronja “a” dhe neni 43, shkronja “c” të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”
18	Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës së një personi për zotërimin ose ndryshimin, nëpërmjet blerjes, shitjes dhe/ose transferimit së pjesëmarrjes influencuese të aksioneve të një banke.	Neni 24, pika 1, shkronja “gj” dhe “h”, neni 25, pika 1 dhe 2 të ligjit “Për bankat”



19	<ul style="list-style-type: none"> - Vendimi për miratimin e shndërrimit të degës së bankës së huaj në filial/bankë vendëse me kërkesë të vetë bankës së huaj. - Vendimi për shndërrimin e detyrueshëm të degës së bankës së huaj në filial/bankë vendëse kur gjykohet i nevojshëm nga Banka e Shqipërisë. - Vendimi për zgjatjen e afatit të procesit të shndërrimit të degës së bankës së huaj në filial/bankë. 	Neni 29/1, pika 2, 3 dhe 6 të ligjit “Për bankat”
----	--	---

SHTOJCA NR. 2

KOMPETENCA VENDIMMARRËSE TË GUVERNATORIT PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

NR.	KOMPETENCA VENDIMMARRËSE	Referenca ligjore dhe rregullative
1	Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet kompetente mbikëqyrëse brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me mbikëqyrjen e bankave dhe degëve të bankave të huaja.	Neni 72, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 73, pika 2 të ligjit “Për bankat”
2	Lidhja dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet kompetente mbikëqyrëse në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve bankare dhe financiare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në disa vende të ndryshme (Kolegjet Mbikëqyrëse).	Neni 82, pika 4 e ligjit “Për bankat”
3	<ul style="list-style-type: none"> - Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës për zgjerimin e rrejtës së bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. - Vendimi për refuzimin e ofrimit të shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkuftare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga banka. 	Neni 24, pika 1, shkronja “P” dhe neni 26, pika 3 të ligjit “Për bankat”
4	Urdhër për ndalimin e hapjes së degëve të reja, zgjerimit të rrejtës bankar, si dhe fillimit të veprimtarive të reja.	Neni 81, shkronja “d” e ligjit “Për bankat”
5	Urdhër për ndërprerjen e një ose disa veprimtarive bankare dhe/ose financiare të bankës ose degës së bankës së huaj.	Nenet 76/1 dhe 79/1/ë të ligjit “Për bankat”
6	Urdhër për ndalimin e ndarjes së fitimit të bankës.	Neni 81, shkronja “a” e ligjit “Për bankat”
7	Urdhër për përjashtimin e ekspertit kontabël të autorizuar për një periudhë 5-vjeçare nga auditimi i bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja.	Neni 51, pika 2 e ligjit “Për bankat”
8	Urdhër për tjetërsimin e të drejtave të pronësisë mbi aksionet e një aksioneri që nuk plotëson më kërkesat mbi reputacionin moral ose që dënohet me një vendim penal të formës së prerë.	Neni 25, pika 8 e ligjit “Për bankat”

SHTOJCA NR. 3

KOMPETENCA TË DELEGUARA ADMINISTRATORIT PËRGJEGJËS NË LIDHJE ME VENDIMMARRJEN PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

NR.	KOMPETENCA VENDIMMARRËSE	Referenca ligjore dhe rregullative
1	Vendimi për miratimin paraprak ose refuzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit të bankës.	Neni 24, pika 1, shkronja “a” e ligjit “Për bankat”
2	Vendimi për miratimin paraprak ose refuzimin e kërkesës për ndryshimin e statutit të bankës.	Neni 24, pika 1, shkronja “b” e ligjit “Për bankat”
3	Vendimi për dhënien e licencës ose refuzimin e kërkesës për licencim si subjekt financiar jo bankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike.	Neni 126 i ligjit “Për bankat”; neni 10 i rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo banka”



4	Vendimi për pezullimin ose revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë si subjekt financiar jo bankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike.	Neni 14 i rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo banka”
5	Vendimi për miratimin ose refuzimin e kërkesës për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë nga subjektet financiare jo banka.	Neni 16, pika 1, shkronja “a” dhe “e”, si dhe neni 18 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo banka”
6	Urdhër për bankën për thirrjen e asamblesë së aksionerëve për zbatimin e kërkesës për rritjen e kapitalit.	Neni 79/1/b

SHTOJCA NR. 4

KOMPETENCA TË DELEGUARA DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES NË LIDHJE ME VENDIMMARRJEN PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

NR.	KOMPETENCA VENDIMMARRËSE	Referenca ligjore dhe rregullative
	I. BANKAT	
1	Vendim për ndërprerjen e procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e miratimit paraprak për licencë, pas kalimit të afatit 12-mujor, për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm nga data e paraqitjes së kërkesës.	Neni 19, pika 6 e ligjit “Për bankat”
2	Vendim për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës së bankës ose degës së bankës së huaj për përfundimin me të tretët të marrëveshjes për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi për administrimin dhe drejtimin e bankës.	Neni 24, pika 1, shkronja “c” e ligjit “Për bankat”
3	Vendim për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës për zmadhimin e kapitalit të bankës me mjete jolikuide.	Neni 24, pika 1, shkronja “d” e ligjit “Për bankat”
4	Vendim për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës së bankës për të riblerë aksionet e saj ose të personave të lidhur me të.	Neni 24, pika 1, shkronja “dh” e ligjit “Për bankat”
5	- Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimit të kërkesës për zvogëlimin e kapitalit të bankës. - Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimit për zvogëlimin e kapitalit nëpërmjet riblerjes së aksioneve ose shpërndarjes së fondeve rezervë.	Neni 24, pika 1, shkronja “e” dhe neni 70, pika 3 të ligjit “Për bankat”
6	Vendim për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës për emërimin e një ose disa administratorëve të bankës ose degës së bankës së huaj.	Neni 24, pika 1, shkronja “ë”, pika 2, shkronja “b” dhe neni 42/1 të ligjit “Për bankat”
7	Vendim për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës për bankën, të investojë mbi 15 për qind të kapitalit të saj rregullator në kapitalin e një personi juridik që nuk ushtron veprimtari bankare.	Neni 24, pika 1, shkronja “g” e ligjit “Për bankat”
8	Urdhri për largimin/shkarkimin e një ose disa administratorëve të bankës ose degës së bankës së huaj.	Nenet 43, 79, pika 2 dhe neni 89/4/b të ligjit “Për bankat”
9	- Urdhri për vendosjen e gjobave për administratorët e bankave ose të degës së bankës së huaj dhe/ose për bankën ose degën e bankës së huaj. - Urdhri për dyfishimin e sanksioneve.	Neni 89, pika 1, shkronja “a”, pikat 2, 3 dhe 4 të ligjit “Për bankat”
10	Urdhër për dhënien e vërejtjeve me paralajmërim me shkrim për administratorët e bankës dhe degës së bankës së huaj.	Neni 89, pika 1, shkronja “b” e ligjit “Për bankat”
11	Urdhër për pezullimin nga detyra të administratorëve të bankës dhe/ose degës së bankës së huaj, deri në 12 muaj.	Neni 89, pika 4, shkronja “a” e ligjit “Për bankat”
12	Urdhër për ndërprerjen e shpërblimit të administratorëve nga banka ose dega e bankës së huaj.	Neni 89, pika 4, shkronja “c” e ligjit “Për bankat”



13	Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose refuzimin e kërkesës për zgjerimin e rrjetit të bankave ose degëve të bankave të huaja brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.	Neni 24, pika 1, shkronja “j” dhe pika 2, shkronja “c” e ligjit “Për bankat”; dhe nenet 14 dhe 16 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja”
14	Vendimi/Urdhri për dhënien e miratimit paraprak ose ndryshimin e ekspertit kontabël të autorizuar.	Neni 48, pika 2 e ligjit “Për bankat”
15	Urdhri për ribërjen e auditimit nga një tjetër ekspert kontabël i autorizuar.	Neni 51, pika 1 e ligjit “Për bankat”
16	Vendimi për dhënien e miratimit ose pezullimin e së drejtës për ofrimin e shërbimit <i>e-banking</i> .	Neni 6 dhe neni 7 të rregullores “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”
17	Urdhër për pezullimin e pjeshëm ose të plotë të shërbimit <i>e-banking</i> .	Neni 7 i rregullores “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare të kryera në rrugë elektronike”
18	Vendimi për miratimin paraprak për përfshirjen e instrumenteve në kapitalin shtesë të nivelit të parë dhe instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë.	Neni 21, pika 3, dhe neni 30, pika 4 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”
19	Vendimi për miratimin paraprak për shlyerjen e instrumenteve të kapitalit të nivelit të parë dhe të dytë, pesë vite përpara datës së emetimit të tyre.	Neni 39, pika 3 e rregullores “Për kapitalin rregullator”
20	Urdhër për uljen e shpenzimeve të bankës.	Neni 81, shkronja “b” e ligjit “Për bankat”
21	Urdhër për kufizimin e mjeteve financiare të bankës, përfshirë zërat me rrezik jashtë bilancit.	Neni 81, shkronja “c” e ligjit “Për bankat”
22	Urdhër për ndalimin e bankës për të kryer investime në pjesëmarrje me persona të tjerë juridikë.	Neni 81, shkronja “ç” e ligjit “Për bankat”
23	Urdhër për ndalimin e rritjes së ekspozimit të bankës ndaj një personi.	Neni 81, shkronja “dh” e ligjit “Për bankat”
24	Urdhër për korrigjimin dhe ripublikimin e informacioneve të bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja.	Neni 53, pika 5, e ligjit “Për bankat”
25	Vendim për paralajmërimin e subjekteve për mosrespektim të standardeve për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme dhe paraqitjen e një plani/marrëveshjeje për këtë qëllim.	Neni 74, pika 2, shkronja “a” dhe neni 75, pika 1 të ligjit “Për bankat”
26	Urdhër për raportime më të shpeshta nga banka dhe dega e bankës së huaj.	Neni 10 i rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”
27	Urdhër për informacion të zgjeruar dhe më të shpeshtë nga banka dhe dega e bankës së huaj.	Neni 20, pika 3 e rregullores “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”
28	Urdhër për caktimin e masave në lidhje me urdhrin për eliminimin dhe ndreqjen e veprimeve në kundërvajtje me rregullat për administrimin e rrezikut.	Nenet 76/1 dhe 79 /1/a, c, ç, d, dh, e, f të ligjit “Për bankat”
29	Strategjia e mbikëqyrjes për çdo bankë ose degë të bankës së huaj.	
30	Raporti i ekzaminimit të bankës ose degës së bankës së huaj.	
31	Analiza tremujore e gjendjes financiare të sistemit bankar dhe mbi gjetjet e ekzaminimeve në vend.	
32	Vlerësimi (analiza <i>off-site</i>) mbi baza tremujore i bankave individuale sipas sistemit të vlerësimit të rreziqeve (SVR) dhe sistemit të paralajmërimit të hershëm (SPH).	
II. SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA		
1	Vendimi për dhënien ose refuzimin e miratimit paraprak për kërkesën e subjekteve financiare jo banka ose institucioneve financiare të mikrokredisë për:	Neni 16, pika 1, shkronjat “b”, “c”, “d” të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e



	a) zvogëlimin e kapitalit; b) emërimin e një ose disa administratorëve; c) transferimin e pronësinë së një ortaku ose aksioneri me pjesëmarrje influencuese ose kontrollin e subjektit.	veprimtarisë nga subjektet financiare jo banka”
2	Analiza tremujore e institucioneve financiare jo banka.	
3	Raporti i ekzaminimit të subjektit financiar jo bankë.	
	III. SHKK DHE UNIONET E TYRE	
1	Urdhër për ndryshimin e audituesit ligjor.	Neni 32, pika 9 e ligjit “Për SHKK”
2	Urdhër /vendim për caktimin e SHKK-ve që duhet të emërojnë një shoqëri auditimi.	Neni 32, pika 12 e ligjit “Për SHKK”
3	Vendim për dhënien ose refuzimin e licencës (Unioni).	Neni 44, pika 3 e ligjit “Për SHKK”; neni 19 i rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”
4	Vendim për miratimin ose refuzimin e njësisë organizative, përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit të SHKK-ve.	Neni 46, pika 4 e ligjit “Për SHKK”; neni 22, pika 1, shkronja “a” e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”
5	Vendim për miratimin e emërimit, shkarkimit ose lirimit nga detyra të drejtuesit të njësisë organizative, përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit të SHKK-ve.	Neni 46, pika 6 e ligjit “Për SHKK”; neni 22, pika 1, shkronja “b” e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”
6	Vendimi për lënien në fuqi, shfuqizimin ose ndryshimin e masës së vendosur nga Unioni ndaj SHKK-së.	Neni 49, pika 7 e ligjit “Për SHKK”
7	Urdhër për revokimin e licencës të SHKK-së të përthithur ose SHKK-të të cilat bashkohen në rastin e një bashkimi me krijim, ose të SHKK-së e cila ndahet duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë SHKK-ve ekzistuese apo të themeluara rishtazi.	Neni 50, pika 3 dhe neni 51, pika 3 të ligjit “Për SHKK”
8	Vendim për dhënien e miratimit ose refuzimin e bashkimit, ose ndarjes së SHKK-ve.	Neni 54 i ligjit “Për SHKK”
9	Vendim për dhënien e miratimit ose refuzimin e shndërrimit të Unionit në SHKK.	Neni 58 i ligjit “Për SHKK”
10	Vendim për revokimin e licencës të SHKK-ve, anëtare në Unionin e shndërruar në SHKK.	Neni 59, pika 4 e ligjit “Për SHKK”
11	Vendimi për revokimin e licencës së SHKK-së.	Neni 70, pika 4 e ligjit “Për SHKK”
12	Vendimi për dhënien ose refuzimin e licencës (SHKK).	Neni 72 i ligjit “Për SHKK”
13	Vendimi për miratimin ose refuzimin e kërkesës për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë nga SHKK-ja.	Neni 34, pika 4 e ligjit “Për SHKK”, neni 16, pika 1, shkronja “a” e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”
14	Vendimi për dhënien ose refuzimin e miratimit paraprak për emërimin e kryetarit të këshillit drejtues, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit.	Neni 16, pika 1, shkronja “b” e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”
15	Urdhër për dhënien e masave mbikëqyrëse.	Neni 77 i ligjit “Për SHKK”
16	Urdhër për vendosjen e sanksioneve dhe gjobave.	Neni 78 i ligjit “Për SHKK”
17	Vendimi për dhënien e miratimit për fillimin e likuidimit vullnetar dhe përcaktimit të masës së zbatimit të rregullave të administrimit të rrezikut në shoqërinë e kursim-kreditit në	Neni 82, pika 5 dhe neni 83, pika 2 të ligjit “Për SHKK”



	likuidim.	
18	Vendimi për vendosjen e SHKK-së në proces likuidimi të detyruar.	Neni 96 i ligjit “Për SHKK”
19	Vendimi për caktimin e likuidatorit të SHKK-së.	Neni 97 i ligjit “Për SHKK”
20	Vendimi për miratimin ose mosmiratimin e raportit të likuidatorit të SHKK-së.	Neni 92, pika 2 e ligjit “Për SHKK”
21	Urdhër për revokimin e licencës së SHKK-së pas miratimit të raportit të likuidatorit.	Neni 93, pika 1 e ligjit “Për SHKK”
22	Vendimi për lejimin e vijimit të procedurave gjyqësore dhe të ekzekutimit të detyrueshëm ndaj SHKK-së që është në proces likuidimi të detyrueshëm.	Neni 99, pika 1, shkronja “b” e ligjit “Për SHKK”
23	Vendim për pranimin ose refuzimin e kundërshtimit në lidhje me regjistrimin e detyrimeve të prapambetura të përcaktuara nga likuidatori.	Neni 101, pika 3 e ligjit “Për SHKK”
24	Autorizim për dhënien e pagesave dhe shumave më të larta se nëpunësit e SHKK-së, për nëpunësit profesionistë, të caktuar dhe të emëruar nga likuidatori për ndihmë.	Neni 105 i ligjit “Për SHKK”
25	Raporti i ekzaminimit të unionit dhe/ose shoqërisë së kursim-kreditit.	
26	Analiza gjashtëmujore e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre.	
IV. ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR		
1	Vendimi për dhënien ose refuzimin e kërkesës për licencimin e subjektit për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor.	Neni 10, pika 1 e rregullores “Për licencimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”
2	Vendimi për marrjen e masave administrative ndaj zyrave të këmbimit valutor, si dhe pezullimin ose revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor.	Neni 20 dhe neni 21, pikat 1, 2 të rregullores “Për licencimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”
3	Raporti i ekzaminimit të Zyrës së Këmbimit Valutor.	

VENDIM**Nr. 30, datë 7.6.2017**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË
NGA VENETO BANKA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Veneto Banka sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agentit në sigurime.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Veneto Bankës sh.a., pas paraqitjes të licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gent Sejko**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 84 lekë